



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RREGULLA PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGJISË NË KOSOVË

Prishtinë, 29 gusht 2011



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, Nenin 25 dhe 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur më 29.08.2011, miratoi:

RREGULLËN PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGJISË NË KOSOVË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulle është të përcaktojë kriteret dhe kërkesat për licencimin e ndërmarrjeve që kryejnë aktivitete në sektorin e energjisë, procedurën për lëshimin, modifikimin/ndryshimin, transferimin/bartjen, pezullimin/suspendimin, ndërprerjen/tërheqjen e licencës, si dhe të drejtat dhe detyrimet që do të përfshihen në licencë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Rregulla ka për qëllim përkrahjen dhe zhvillimin e sektorit të energjisë përmes:
 - 1.1. kryerjes së aktiviteteve të energjisë në mënyrë transparente, të hapur dhe jodiskriminuese;
 - 1.2. rregullimit të tregut të energjisë në mënyrë që të sigurojë marrëdhënie të paanshme dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit;
 - 1.3. përcaktimit dhe përgatitjes së procedurave mbi çështjet lidhur me lëshimin e licencave në mënyrë sa më të shpejtë, efikase dhe ekonomike;
 - 1.4. krijimit dhe monitorimit të tregut konkurrues, parandalimit dhe ndëshkimit të çdo sjelljeje abuzive apo antikonkurruese;
 - 1.5. krijimit të kushteve për shfrytëzimin efikas, me kosto efektive, dhe të sigurt të energjisë elektrike dhe termike/ ngrohjes;
 - 1.6. balancimit në mënyrë të drejtë të interesave mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të licencuara për energji;
 - 1.7. mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, sigurisë dhe ambientit.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke zhvilluar të drejtat, obligimet dhe kushtet e licencës, ka për qëllim që të obligojë dhe të stimulojë ndërmarrjet për energji që të veprojnë në atë mënyrë që t'i arrijnë të gjitha objektivat që përcaktohen me Licencë.
3. Për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, ZRRE ka autoritetin dhe përgjegjësinë:



- 3.1. të lëshojë, të modifikojë, të pezullojë, të transferojë, të ndërpresë apo të tërheqë licencat;
- 3.2. të mbikëqyrë dhe të kontrollojë pajtueshmërinë me kushtet e licencës;
- 3.3. të monitorojë shthurjen ligjore, organizative, vendimmarrëse dhe të llogarive të ndërmarrjeve për energji;
- 3.4. të rishikojë, të miratojë dhe të kontrollojë pajtueshmërinë me të gjitha kodet, duke përfshirë kodin e rrjetit, kodin e shpërndarjes, kodin e mbrojtjes së konsumatorëve, kodin e pajisjeve elektrike, kodin e standardeve elektrike, kodin e matjes, rregullat e tregut, dhe kodet tjera teknike dhe komerciale;
- 3.5. të japë pëlqime për ndarjen, shuarjen ose zvogëlimin e kapitalit fillestar të ndërmarrjeve të licencuara për energji.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **“Aplikues”** - personi fizik apo juridik që aplikon për licencim të aktivitetit të energjisë, në pajtim me kushtet e kësaj rregulle.
 - 1.2. **“ZRRE”** - Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.3. **“Aktivitete të energjisë”** - realizimi i një apo më shumë veprimtarive të prodhimit, transmissioinit, shpërndarjes, furnizimit, importit/eksportit dhe transitit të energjisë;
 - 1.4. **“Licenca”** - dokumenti i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushrojë aktivitete në sektorin e energjisë, për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë; dhe
 - 1.5 **“Ngrohje qendrore”** - nënkupton ngrohje të hapësirave dhe përgatitje të ujit të ngrohtë sanitar nga qendrat e burimeve të energjisë termike.
2. Termat e përdorura në këtë rregull do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorura në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohjen Qendrore dhe Ligjin për Gazin Natyror.

Neni 4 Aktivitetet e licencuara

1. Sipas Nenit 27, paragrafi 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, licenca kërkohet për kryerjen e aktiviteteve të energjisë si në vijim:
 - 1.1. prodhimin e energjisë elektrike;
 - 1.2. prodhimin e ngrohjes;



- 1.3. bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - 1.4. transmetimin e energjisë elektrike, përfshirë operimin e sistemit të transmisionit;
 - 1.5. bartjen e gazit natyror;
 - 1.6. shpërndarjen e energjisë elektrike, përfshirë operimin e sistemit të shpërndarjes;
 - 1.7. furnizimin publik me energji elektrike;
 - 1.8. shpërndarjen e ngrohjes qendrore apo gazit natyror;
 - 1.9. deponimin e gazit natyror;
 - 1.10. furnizimin me energji elektrike, ngrohje apo gaz natyror, duke përfshirë transitin, importin dhe eksportin e energjisë elektrike ose gazit natyror;
 - 1.11. operimin e tregut të energjisë elektrike apo gazit natyror;
 - 1.12. transitin, importin apo eksportin e energjisë elektrike apo gazit natyror.
2. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të kryejë aktivitete në sektorin e energjisë, të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse nuk është pajisur me licencë të lëshuar nga ZRRE.
 3. Licencimi i aktiviteteve të energjisë do të bazohet në kriteret që janë jodiskriminuese, publike dhe transparente.
 4. Aktivitetet e energjisë për të cilat nuk kërkohet licencë:
 - 4.1. prodhimi i energjisë elektrike në lokacion energjetik me kapacitet total që nuk tejkalon 5 MW;
 - 4.2. prodhimi i ngrohjes së prodhuar nga ngrohoret për konsum vetjak apo me kapacitet që nuk tejkalon fuqinë e instaluar prej 1 MW;
 - 4.3. prodhimi i energjisë elektrike për konsum vetjak, ku stabilimenti i prodhimit apo konsumatorët e energjisë elektrike nuk lidhen në sistemin e transmisionit apo sistemin e shpërndarjes;
 - 4.4. deponimi i gazit natyror ku kapaciteti total i deponimit nuk tejkalon dhjetëmijë (10.000) metra kub.
 5. Të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me furnizimin, bartjen, shpërndarjen, deponimin, importin, eksportin dhe operimin e tregut të gazit natyror, nuk janë të mbuluara me këtë rregull.

KREU II

PROCEDURA PËR LËSHIMIN E LICENCAVE

Neni 5 **Autoriteti i ZRRE-së**

1. ZRRE ka autoritet që të shqyrtojë të gjitha aplikacionet për licencim dhe të sigurojë që aplikacionet e tilla do të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
2. ZRRE ka autoritet të monitorojë dhe të mbikëqyrë aktivitetet e licencuara, si dhe të kërkojë nga të licencuarit që të raportojnë për kryerjen e këtyre aktiviteteve. Raportimet do të bëhet sipas udhëzimeve të ZRRE-së.



Neni 6 **Aplikimi për licencim**

1. Aplikimi për licencim, modifikim/ndryshim, transferim/bartje dhe vazhdim të licencës bëhet me shkrim dhe në formën e specifikuar nga ZRRE.
2. Aplikuesi duhet të dorëzojë në ZRRE aplikacionin në kopje të shtypura dhe elektronike në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. Në rast se ndonjë dokument/dëshmi është nxjerrë në ndonjë gjuhë tjetër, aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentin e përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të vërtetuar nga noteri.
4. Të gjithë aplikuesit për licencim, modifikim/ndryshim, transferim të licencës etj., do të paguajnë taksën administrative për shqyrtim të aplikacionit sipas Rregullës për Taksat.
5. Aplikuesi duhet të sjellë kopjen e faturës së taksës së paguar, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, pas dorëzimit të aplikacionit për licencim.
6. Taksa e paguar nga aplikuesi për shqyrtim të aplikacionit nuk do të kthehet (rimburësohet) edhe në rastet e refuzimit të aplikacionit.

Neni 7 **Procedura për shqyrtimin e aplikacioneve**

1. Procedura e përcaktuar me këtë rregull do të zbatohet ndaj të gjithë aplikuesve për licencim, duke përfshirë aplikimet për ndryshim, vazhdim, transferim/bartje dhe tërheqje të licencës.
2. ZRRE-ja do të shqyrtojë aplikacionet me të gjitha dëshmitë e bashkangjitura dhe do ta njoftojë aplikuesin në lidhje me vendimin e saj, brenda periudhës së përcaktuar në Nenin 11 të kësaj rregulle.
3. Nëse aplikacioni i dorëzuar konsiderohet i pakompletuar, ZRRE do të kërkojë nga aplikuesi të ofrojë informatat e nevojshme shtesë për kompletim të aplikacionit, të cilat kërkohen sipas rregullave në fuqi, brenda periudhës së specifikuar kohore.
4. Në rast se aplikacioni dhe dokumentet shtesë nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregull, ZRRE-ja do të kërkojë nga aplikuesi, të korrigojë me shkrim aplikacionin e tij brenda periudhës kohore të specifikuar nga ZRRE-ja. Periudha e shqyrtimit të aplikacionit do të fillojë që nga data kur ZRRE e konsideron aplikacionin të kompletuar.
5. Nëse aplikuesi nuk e korrigjon aplikacionin e tij, ose nuk i dorëzon dëshmitë që mungojnë brenda periudhës së përcaktuar, ZRRE-ja do të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet ekzistuese dhe informatat e ofruara dhe do të informojë aplikuesin me shkrim. ZRRE-ja mund të refuzojë lëshimin e licencës pa njoftim paraprak, për shkak të mosdorëzimit të informacioneve të domosdoshme.



Neni 8

Publikimi i njoftimit për aplikim

1. Pas përcaktimit nga ana e ZRRE-së se aplikacioni për licencë është i kompletuar, ZRRE-ja do ta udhëzojë aplikuesin që të publikojë në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të madh në Kosovë një njoftim, në të cilin përshkruhet:
 - 1.1. një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së aplikacionit, dhe
 - 1.2. udhëzimi për palët e interesuara se mund të shprehin interesin e tyre për të kundërshtuar një projekt të tillë brenda tetë (8) ditësh pune në ZRRE, nga data e shpalljes së njoftimit.
2. Nëse ZRRE ka pranuar ndonjë kundërshtim për aplikacion, do t'ia paraqesë një kopje të tij aplikuesit dhe do ta publikojë në ueb faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Aplikuesi dhe/ose ZRRE-ja nuk do të zbulojnë asnjë informacion që konsiderohet si konfidencial, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.

KREU III

KËRKESAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR APLIKIM

Neni 9

Kërkesat e përgjithshme

1. Secili aplikues që aplikon për licencë duhet të dorëzojë në ZRRE dokumentet si në vijim:
 - 1.1. certifikatën e regjistrimit të aplikuesit si Organizatë biznesore, që i është lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave biznesore;
 - 1.2. planin e biznesit (afarist) të aplikuesit për tre (3) vitet e ardhshme;
 - 1.3. pasqyrat financiare vjetore të aplikuesit për tre (3) vitet e fundit. Këto pasqyra financiare duhet të jenë të audituara nga auditorë të licencuar dhe të pavarur financiarë. Aplikuesi do të dorëzojë raportin e auditorëve veçmas nga gjendja financiare, ndërsa ndërmarrja e sapokrijuar të dorëzojë deklaratën financiare dhe informacione në lidhje me përvojën e partnerëve ose aksionarëve të tij, nëse ka, në përmbushjen e aktiviteteve të ngjashme për energji;
 - 1.4. vërtetimin nga një institucion financiar ose institucion tjetër që konfirmon ekzistencën e fondeve të mjaftueshme për ushtrimin e aktiviteteve për energji (p.sh. garanci bankare të aplikuesit apo kompanisë mëmë në rast të subvencionit, ose evidencë të ngjashme të fondeve të mjaftueshme për të financuar aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);
 - 1.5. kopje të vërtetuar të regjistrimit të aksioneve ose pjesëmarrjes reale të cilitdo nga aksionarët ose partnerët e aplikuesit (p.sh. marrëveshjen e krijimit të shoqërisë, vendimin e gjykatës, kopjen e vërtetuar të regjistrimit të aksionarëve, statutin e ndërmarrjes, etj.);



- 1.6. certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;
 - 1.7. certifikatën nga organi kompetent që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;
 - 1.8. detajet e përvojës së aplikuesit për kryerjen e aktiviteteve të energjisë në formë të biografisë (Curriculum Vitae - CV) së ndërmarrjes;
 - 1.9. informacione në lidhje me strukturën organizative (menaxhmentin dhe personelin profesional) të aplikuesit;
 - 1.10. biografite (CV-të) e stafit menaxhues dhe personelit tjetër të lartë të aplikuesit, së bashku me kualifikimet e tyre; dhe
 - 1.11. dëshmi për pagesën e taksës së aplikueshme për licencim (në pajtim me Nenin 6.5 të kësaj rregulle).
2. Aplikuesi do të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që dëshmon se i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi në Kosovë dhe se nuk ka bërë shkelje në Kosovë apo jashtë saj për sa i përket:
- 2.1. kushteve të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë;
 - 2.2. kriterëve teknike në lidhje me operimin e sistemeve të prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes; dhe
 - 2.3. mbrojtjes së mjedisit.

Neni 10 Deklarimi i aplikuesit

1. Përveç dëshmive të kërkuara me Nenin 9 të kësaj rregulle, aplikuesi do të deklarojë në ZRRE në formë të shkruar që:
 - 1.1. menaxherët e aplikuesit nuk janë dënuar apo nuk janë të ndjekur penalisht për vepra penale;
 - 1.2. licenca e aplikuesit për aktivitetin për të cilin aplikon nuk është tërhequr brenda pesë (5) vjetëve që nga data kur është dorëzuar aplikacioni;
 - 1.3. ekzistojnë të gjitha aprovimet e nevojshme për mbrojtjen e ambientit, ose aprovimet të tjerë të specifikuar në ligjet në fuqi; dhe
 - 1.4. aplikuesi i kupton dhe është i vetëdijshëm për obligimet e tij që të zbatojë legjislacionin për sektorin e energjisë, rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja, kodet teknike dhe komerciale dhe legjislacionin tjetër në fuqi.



Neni 11

Kërkesat specifike të licencës për prodhim

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për prodhim të energjisë elektrike, prodhim të ngrohjes apo bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe ngrohjes, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. të dhëna mbi stabilimentet kryesore dhe ato ndihmëse për energji, llojin dhe specifikat teknike të tyre dhe të dhëna mbi vendndodhjen e stabilimenteve energjetike;
 - 1.2. dëshmi mbi sigurimin e karburantit dhe/apo kontratën paraprake apo finale mbi furnizimin me karburant;
 - 1.3. marrëveshjen për kyçje në rrjet;
 - 1.4. lejen mjedisore, lëshuar nga institucioni kompetent;
 - 1.5. planin për dekomisionim të stabilimentit;
 - 1.6. planin për rehabilitim të stabilimentit (aty ku është e aplikueshme);
 - 1.7. dëshmi për të drejtën pronësore të shoqëruar me skica dhe harta të pronës dhe stabilimenteve përkatëse;
 - 1.8. çdo kontratë eventuale për shitje të energjisë, në formën përfundimtare nëse është e mundur, apo edhe në formë të draftit;
 - 1.9. dëshmi për efikasitet termik;
 - 1.10. lejen për shfrytëzim të ujit (aty ku është e aplikueshme);
 - 1.11. vlerësimin e kostos së energjisë së prodhuar gjatë kohëzgjatjes së kapaciteteve të reja prodhuese ose kohëzgjatjes së mbetur të stabilimentit të rehabilituar; dhe
 - 1.12. planin amortizues (të zhvlerësimit) për stabilimentin prodhues.

Neni 12

Kërkesat specifike të licencës për operator të sistemit të transmisionit

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për operator të sistemit të transmisionit, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. përshkrim të karakteristikave të sistemit të transmisionit përkatës për transmetimin e energjisë dhe dëshmi për të drejtën pronësore, për të shfrytëzuar elementet e sistemit;
 - 1.2. planin për zhvillimin e sistemit, siç përcaktohet në Nenin 12, paragrafin 1, nënparagrafin 1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe Nenin 7 të Ligjit për Energjinë, duke përfshirë edhe ndikimin e zhvillimit të sistemit në tarifatat e aprovuara nga ZRRE.



- 1.3. dëshmi mbi kapacitetet ndërkufitare;
- 1.4. dëshmi për posedimin e sistemit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm për përlogaritjen e rrjedhave të ngarkesës, për menaxhimin e dispeçimit të centraleve për prodhim të energjisë, shërbimeve ndihmëse dhe lidhjeve të shkurta, stabiliteti dinamik i tregut të balancimit, dhe për menaxhimin e kongestionit, nëse është e aplikueshme, si dhe deklaratën për blerjen ose sigurimin e sistemeve të përmendura;
- 1.5. specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse në pikat e faturimit të energjisë elektrike; dhe
- 1.6. deklaratën se aplikuesi do të përmbushë të gjitha obligimet e tij të dala nga licenca dhe që do të zhvillojë dhe do të implementojë të gjitha kodet teknike, siç përcaktohen me Ligjin për Energjinë Elektrike.

Neni 13

Kërkesat specifike të licencës për operator të tregut

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për operator të tregut të energjisë elektrike, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. dëshmi për posedimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për komunikim me të gjitha pikat matëse, me të gjithë pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë edhe OST-në; dhe
 - 1.2. deklaratën se aplikuesi është i vetëdijshëm për obligimet e tij për të zhvilluar dhe zbatuar Rregullat e Tregut.

Neni 14

Kërkesat specifike të licencës për operator të sistemit të shpërndarjes

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike apo ngrohjes, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. një përshkrim të karakteristikave përkatëse të sistemit të shpërndarjes dhe territorit për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - 1.2. dëshmi lidhur me pronësinë ose të drejtën ligjore për përdorimin e elementeve të sistemit;
 - 1.3. planin zhvillimor të sistemit, siç përcaktohet në Nenin 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenin 7 të Ligjit për Energjinë, dhe në Nenin 15 paragrafi 3, nënparagrafi 3.2, të Ligjit për Ngrohjen Qendrore;
 - 1.4. dëshmi lidhur me numrin dhe strukturën e konsumatorëve të kyçur dhe atyre potencialë;



- 1.5. dëshmi për posedimin e sistemeve të harduerit dhe softuerit të nevojshme për llogaritjen e rrjedhave të ngarkesës të sistemit energjetik, lidhjeve të shkurta dhe deklaratën për blerjen ose sigurimin e sistemeve të përmendura;
- 1.6. treguesit për matjen e kualitetit të furnizimit me energji (kohëzgjatjen, frekuencat, numrin e ndërprerjeve, ndërprerjet e shprehura në minuta për konsumator etj.) dhe shërbimet në operimin e sistemit (informatat e përgjithshme, marrëveshjet për leximin e njehsorëve, kohën e kyçjes, dështimet, rivendosjen e sistemit energjetik pas dështimeve etj);
- 1.7. specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse të sistemit të shpërndarjes; dhe
- 1.8. marrëveshjen për kyçje në sistemin e transmisionit.

Neni 15

Kërkesat specifike për licencë të furnizimit publik

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për furnizim publik me energji elektrike apo ngrohje, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. raport mbi përmbushjen e standardeve për furnizim të konsumatorëve, përfshirë: ankesat e konsumatorëve, kohën e përgjigjes ndaj ankesave të konsumatorëve, propozimet për faturimin, kohën e përgjigjes në qendrën e thirrjes, kohën mesatare të pritjes në qendrat për informim të konsumatorëve etj; dhe
 - 1.2. të dhëna mbi burimet materiale në pronësi të aplikuesit, duke përfshirë të dhëna për sistemin informativ dhe softuerin në dispozicion për kryerjen e aktiviteteve.

Neni 16

Kërkesat specifike për licencë të furnizimit

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për furnizim me energji elektrike dhe ngrohje, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. të dhëna mbi burimet materiale në pronësi të aplikuesit, duke përfshirë të dhëna për sistemin informativ dhe softuerin në dispozicion për kryerjen e aktiviteteve;
 - 1.2. kontratat/marrëveshjet për furnizim me energji elektrike dhe ngrohje;
 - 1.3. numrin dhe kategoritë e konsumatorëve; dhe
 - 1.4. planin mbi përmbushjen e standardeve për furnizim të konsumatorëve, përfshirë: ankesat e konsumatorëve, kohën e përgjigjes ndaj ankesave të konsumatorëve, propozimet për faturim, kohën e përgjigjes në qendrën e thirrjes, kohën mesatare të pritjes në qendrat për informim të konsumatorëve etj.



Neni 17

Kërkesat specifike të licencës për import/eksport dhe transit

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për import/eksport dhe transit të energjisë elektrike, përveç kërkesave sipas Nenit 9 dhe 10 të kësaj rregulle, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. një përshkrim të aktivitetit energjetik të planifikuar; dhe
 - 1.2. dëshmi mbi çfarëdo licence që aplikuesi posedon në lidhje me aktivitetet e energjisë, si në Kosovë apo në ndonjë vend tjetër.

Neni 18

Aplikacioni dhe afati për shqyrtim të aplikacionit

1. Aplikacioni për licencim të aktiviteteve të energjisë në Kosovë do të hartohet dhe do të publikohet nga ZRRE-ja.
2. Sipas nevojës, ZRRE mund të hartojë aplikacione për secilin aktivitet të energjisë të përshkruar në Nenin 27, paragrafi 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
3. ZRRE do të marrë një vendim formal për secilin aplikacion brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike, nga parashtrimi i aplikacionit të kompletuar. ZRRE do ta informojë aplikuesin për datën kur aplikacioni i tij konsiderohet i kompletuar.
4. Në rastet e refuzimit të licencës, aplikuesi nuk mund të parashtrojë kërkesë të re për licencim para nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike, nga data e refuzimit të aplikacionit.
5. ZRRE mund ta refuzojë dhënien e licencës në pajtim me Nenin 33 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
6. Po ashtu, dhënia e ndonjë informate false ose mashtruese nga aplikuesi do të jetë bazë për refuzim të aplikimit, ose, nëse zbulohet pas lëshimit të licencës, do të jetë bazë për tërheqje të licencës ose për vendosjen e ndonjë sanksioni tjetër nga ZRRE-ja.

KREU IV

KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS

Neni 19

Kriteret e përgjithshme për dhënien e licencës

1. Në pajtim me Nenin 29 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE përcakton kriteret që do të plotësohen nga aplikuesi në mënyrë që t'i lëshohet licenca.
2. Aplikuesit që ka aplikuar për marrjen e licencës mund t'i lëshohet licenca, nëse ZRRE ka vlerësuar se ai, përveç të tjerash, ka përmbushur kriteret e përgjithshme si në vijim:



- 2.1. ka poseduar mundësi teknike dhe financiare, burime materiale dhe njerëzore dhe strukturë organizative për plotësimin e kërkesave të licencës;
- 2.2. ka të drejtë pronësore ose të drejtë ligjore për shfrytëzimin e stabilimenteve të energjisë me të cilat kryhet aktiviteti;
- 2.3. siguron fakte që stabilimentet e energjisë, të cilat do të përdoren për kryerjen e aktivitetit, i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit;
- 2.4. nuk është në paaftësi të pagimin të taksave dhe nuk është në proces të likuidimit apo të falimentimit;
- 2.5. nuk i është revokuar licenca për të njëjtin aktivitet brenda pesë (5) viteve përpara datës së parashtrimit të aplikacionit;
- 2.6. nuk do ta dëmtojë funksionimin e sistemit energjetik apo të ngrohjes;
- 2.7. do të operojë në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës;
- 2.8. nuk do të rrezikojë ose pengojë zhvillimin e konkurrencës në treg të hapur; dhe
- 2.9. i plotëson të gjitha kërkesat mjedisore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Kosovë si dhe me Direktivat e BE-së për mjedisin, si dhe ka programe të përshtatshme për monitorim të vazhdueshëm të ambientit.

Neni 20

Kriteret e veçanta për dhënien e licencës

1. Aplikuesit që aplikuar për marrjen e licencës për Prodhim të energjisë, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriteret si në vijim:
 - 1.1. ka aftësi të sigurojë shërbimet ndihmëse;
 - 1.2. përdor teknologjinë moderne;
 - 1.3. dëshmon sigurimin adekuat të lëndës djegëse, dhe
 - 1.4. ka kapacitet financiar dhe teknik që të sistemojë të gjitha mbeturinat që lidhen me prodhimin dhe t'i dekomisionojë dhe/apo largojë të gjitha stabilimentet prodhuese, në përputhje me kërkesat teknike dhe të mjedisit.
2. Aplikuesit që ka aplikuar për marrjen e licencës për Operimin e Sistemit të Transmisionit, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriteret si në vijim:
 - 2.1. posedon pajisje matëse të instaluar në pikat e dërgimit të energjisë;



- 2.2. ka të themeluar sistem efikas për leximin e njehsorëve me qëllim të faturimit të energjisë; dhe
 - 2.3. i mundëson qasje palës së tretë në sistemin e transmisionit të energjisë.
3. Aplikuesit që ka aplikuar për marrje të Licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriteret si në vijim:
 - 3.1. posedon pajisje matëse të instaluara në pikat e dërgimit të energjisë elektrike/ngrohjes;
 - 3.2. ka të themeluar sistem efikas për leximin e njehsorëve për qëllim të faturimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes; dhe
 - 3.3. i mundëson qasje palës së tretë në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ngrohjes.
 4. Aplikuesit që ka aplikuar për marrjen e Licencës për Furnizim Publik, përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriteret si në vijim:
 - 4.1. janë plotësuar në mënyrë të sigurt dhe ekonomike të gjitha kërkesat për pajisjet e domosdoshme matëse dhe të faturimit për shpenzimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes për konsumatorët e rregulluar, dhe
 - 4.2. i përmbush të gjitha detyrimet e aplikueshme të shërbimeve publike.
 5. Aplikuesit që ka aplikuar për marrjen e licencës për furnizim, përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriteret si në vijim:
 - 5.1. janë plotësuar në mënyrë të sigurt dhe ekonomike të gjitha kërkesat për pajisjet e domosdoshme matëse dhe të faturimit për shpenzimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes për konsumatorët e rregulluar, dhe
 - 5.2. ka reputacion të mirë për kryerjen e aktivitetit të energjisë.
 6. Aplikuesit që ka aplikuar për marrjen e licencës për import/eksport dhe transit të energjisë, përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në Nenin 19 të kësaj rregulle, mund t'i lëshohet licenca nëse ZRRE ka vlerësuar se ai ka përmbushur edhe kriterin si në vijim:
 - 6.1 ka reputacion të mirë për kryerjen e aktivitetit të energjisë.



KREU V

TERMAT DHE KUSHTET E LICENCAVE

Neni 21

Termt dhe kushtet e përgjithshme

1. Secila licencë duhet të përfshijë termt dhe kushtet e domosdoshme për përmbushjen e aktiviteteve të licencuara, dhe vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve ndaj të licencuarve, pavarësisht nga lloji i aktiviteteve për energji.
2. Secila licencë duhet të përmbajë dispozitat e përgjithshme si në vijim:
 - 2.1. bazën ligjore për lëshimin e licencave;
 - 2.2. llojin e aktivitetit të energjisë së licencuar;
 - 2.3. përkufizimet;
 - 2.4. përmbushjen e aktivitetit të licencuar;
 - 2.5. territorin e mbuluar nga licenca, nëse është e aplikueshme;
 - 2.6. pronësinë apo të drejtën ligjore për të shfrytëzuar territorin, stabilimentin dhe pjesët përbërëse të sistemit;
 - 2.7. stabilimentet kryesore të përdorura për të kryer aktivitetet e licencuara, nëse është e aplikueshme;
 - 2.8. afatet, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e të licencuarve;
 - 2.9. kriteret për t'u përshtatur me të gjithë kodet përkatëse teknike dhe komerciale, përfshirë Rregullat e Tregut;
 - 2.10. domosdoshmërinë e përputhjes me kushtet e përcaktuara në licencat e tyre, ligjet në fuqi dhe rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja;
 - 2.11. dispozitat për standardet e kontabilitetit;
 - 2.12. ndalimin e subvencionimit të tërthortë (ndër-subvencionimi), nëse është i aplikueshëm;
 - 2.13. detyrimet e shërbimeve publike dhe dispozitat për furnizim si masë e fundit, nëse është e aplikueshme;
 - 2.14. integritetin dhe stabilitetin financiar të të licencuarit;
 - 2.15. domosdoshmërinë e përputhjes me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë, si dhe mbrojtjen e ambientit;



- 2.16. dispozitat në lidhje me modifikimin, transferimin, pezullimin, ndërprerjen dhe tërheqjen e licencës;
 - 2.17. obligimin që të mirëmbajë të dhënat lidhur me aktivitetet e licencuara sipas kërkesës;
 - 2.18. dispozitat lidhur me raportimin në ZRRE;
 - 2.19. dispozitat mbi pagesën e taksave;
 - 2.20. dispozitat lidhur me zgjidhjen e kontesteve dhe procedurën e ankesës;
 - 2.21. dispozitat ndëshkimore për shkelje të dispozitave të licencës, etj.
3. Përjashtimisht nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ZRRE-ja mund të përfshijë në licencë edhe kushte të tjera të domosdoshme, me qëllim që të sigurojë përputhshmërinë me objektivat ose kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Termet dhe kushtet e veçanta në llojet e ndryshme të licencave

1. Në Licencën për Prodhim ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
 - 1.1. sigurimin e shërbimeve ndihmëse nga i licencuari, në përputhje me kodet teknike dhe komerciale të tregut të energjisë;
 - 1.2. sigurimin e dispeçimit sipas Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit;
 - 1.3. kriterin për krijimin e raporteve me palët e tjera të tregut të energjisë elektrike dhe ngrohjes, në përputhje me Rregullat e Tregut dhe ligjet në fuqi;
 - 1.4. kriterin që i licencuari të sigurojë matjet e nevojshme të ndikimit në mjedis, në përputhje me ligjet në fuqi;
 - 1.5. sigurimin e rezervave të lëndës djegëse;
 - 1.6. rregullimin e të drejtës për qasje në tokë dhe/ose në stabiliment;
 - 1.7. heqjen apo dhënien në shfrytëzim të pronës të të licencuarit;
 - 1.8. dekomisionimin, heqjen e të gjitha stabilimenteve dhe strukturave, si dhe kthimin e tokës në gjendjen e saj fillestare, etj.
2. Në Licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
 - 2.1. kërkesën që të sigurojë kyçjen në sistemin e transmisionit dhe qasjen e palës së tretë në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese, me dispozita të përshtatshme që definojnë dorëzimin e kërkesës për qasje, procedurat për mohimin e qasjes dhe procedurat e ankimit nga ana e palëve që u është mohuar qasja;



- 2.2. prioritetin e dispeçimit të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë, sipas Nenit 12, paragrafi 1, të Ligjit për Energjinë, Nenit 12, nënparagrafi 1.14, të Ligjit për Energjinë Elektrike, si dhe rregullave të tjera përkatëse;
 - 2.3. obligimin që të publikohen informatat për kapacitetet interkonektive dhe planet për mirëmbajtjen e sistemit të transmisionit dhe kongestionit, sipas ligjeve në fuqi, rregullave dhe Kodeve përkatëse;
 - 2.4. planin zhvillimor të sistemit të transmisionit, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, rregullave dhe kodeve të aplikueshme;
 - 2.5. detyrimin për të ruajtur të dhënat dhe kriteret që informacioni i marrë prej shfrytëzuesve të sistemit të transmisionit të jetë i hapur ndaj publikut, por duke ruajtur informacionet që konsiderohen konfidenciale;
 - 2.6. sigurimin e informacioneve teknike dhe të tregut për shfrytëzuesit e tjerë të sistemit;
 - 2.7. krijimin e një programi përputhshmërie, i cili nxjerr masat e marra për të parandaluar sjelljet diskriminuese të pjesëmarrësve në treg dhe për të siguruar monitorimin adekuat të tij;
 - 2.8. detyrimin për të zhvilluar kodet teknike, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike; dhe
 - 2.9. përgjegjësi të tjera të operatorit të sistemit të transmisionit, siç përcaktohen me ligjet relevante.
3. Në Licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
 - 3.1. kërkesën që të sigurojë kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes dhe qasjen e palës së tretë në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese, me dispozita të përshtatshme që definojnë dorëzimin e kërkesave për qasje, procedurat për mohimin e qasjes dhe procedurat e ankimit nga ana e palëve që u është mohuar qasja;
 - 3.2. karakteristikat e sistemit dhe interkonekcionet (ndërlidhjet);
 - 3.3. planin për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore në pajtim me ligjet në fuqi në sektorin e energjisë;
 - 3.4. sigurimin e informacioneve për shfrytëzuesit e tjerë të sistemit;
 - 3.5. krijimin e një programi përputhshmërie me ligjet relevante, rregullat dhe kodet;
 - 3.6. dispozitat që sigurojnë qasje jodiskriminuese në informata, por duke ruajtur informacionet që konsiderohen konfidenciale;
 - 3.7. informimin e konsumatorëve në mënyrë transparente dhe të qartë mbi kushtet e kyçjes në sistemin e shpërndarjes; dhe



- 3.8. konfirmimin që të gjitha kërkesat për matjet dhe faturimet e konsumatorëve tariforë (të rregulluar) janë përmbushur në mënyrë të sigurt dhe ekonomike;
4. Në Licencën për Furnizim Publik ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
- 4.1. kërkesat sipas Ligjit për Energjinë Elektrike në lidhje me furnizimin publik të konsumatorëve me energji elektrike dhe Ligjit për Ngrohje Qendrore në lidhje me furnizimin publik të konsumatorëve me ngrohje.
- 4.2. dispozitat në lidhje me furnizimin e burimit të fundit, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike dhe ngrohje;
- 4.3. kërkesat për blerjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes në mënyrë ekonomikisht më efikase;
- 4.4. kërkesat për të siguruar që mbajtësi i licencës do t'i informojë të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të drejtën e ankesës për dëmtime, si dhe themelon procedurat e duhura për shqyrtimin e ankesave të tilla, kompensimin, dhe
- 4.5. parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve për konsumatorë.
5. Në Licencën për Furnizim ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
- 5.1. kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe në Ligjin për Ngrohjen Qendrore;
- 5.2. kërkesat për blerjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes në mënyrë ekonomikisht më efikase;
- 5.3. kërkesat për të siguruar që mbajtësi i licencës do t'i informojë të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të drejtën e ankesës për dëmtime, si dhe themelon procedurat e duhura për shqyrtimin e ankesave të tilla, kompensimin; dhe
- 5.4. parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve për konsumatorë;
6. Në Licencën për import/eksport dhe transit ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
- 6.1 kërkesat që përcaktohen me Ligjin mbi Energjinë Elektrike.
7. Në Licencën e Operimit të Tregut ZRRE mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:
- 7.1. kërkesat që përcaktohen me Ligjin për Energjinë Elektrike;
- 7.2. kërkesat për përgatitjen e Rregullave të Tregut siç përcaktohet me Ligjin për Energjinë Elektrike;



7.3. dërgimin e informatave të sakta dhe të besueshme sa i përket çmimeve, numrit të pjesëmarrësve në treg, përqindjen e pjesëmarrësve në treg, çmimet që parashihen dhe statistikat e pjesëmarrësve në treg.

Neni 23

Ndarja e llogarive dhe menaxhimi

1. I licencuari është i detyruar të mbajë llogari të veçanta për:
 - 1.1. aktivitete të ndryshme të energjisë, përfshirë prodhimin, transmissin, shpërndarjen, furnizimin, import/eksportin dhe transitin e energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - 1.2. aktivitetet që i licencuari i kryen jashtë fushëveprimit të licencës; dhe
 - 1.3. aktivitetet e ndara të kryera brenda tregjeve të rregulluara dhe të parregulluara të energjisë elektrike dhe ngrohjes.
2. Të licencuarit i kërkohet të bëjë ndarjen e kontabilitetit/llogarive, menaxhmentit dhe ndarjen ligjore në përputhje me Nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 24

Kohëzgjatja e licencës

1. Kohëzgjatja e licencës është përcaktuar me Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili ka përcaktuar periudhën e licencës që do të aplikohet ndaj llojeve të ndryshme të aktiviteteve për energji, si dhe faktorët që mund të ndikojnë në përcaktimin e kohëzgjatjes së licencës.
2. Kohëzgjatja e çdo licence mund të zgjatet për një periudhë kohore që nuk e tejkalon periudhën relevante kohore të përcaktuar në Nenin 30, paragrafin 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, duke nënkuptuar që i licencuari arrin t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe detyrimet e licencës dhe të ketë parashtruar një kërkesë me shkrim për vazhdimin e licencës aktuale.

KREU VI

QASJA NË TË DHËNAT DHE KRITERET PËR RUAJTJEN E TYRE

Neni 25

Detyrimet vjetore të të licencuarit

1. Sipas termave dhe kushteve të parapara me licencë, i licencuari duhet të dorëzojë në ZRRE, në baza vjetore, dokumentet si në vijim:
 - 1.1. pasqyrat financiare të audituara (informacione financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë bilancet vjetore së bashku me deklaratat mbi të ardhurat dhe shpenzimet, informacionet mbi asetet etj.);
 - 1.2. informacione të specifikuar teknike dhe ekonomike, përfshirë raportin vjetor mbi sigurinë dhe mbrojtjen e stabilimenteve për energji;



- 1.3. çdo kontratë të nënshkruar për tregti ndërkufitare të energjisë elektrike, kontrata furnizimi, marrëveshje të blerjes së energjisë, dhe çdo kontratë të nënshkruar në përputhje me marrëveshjet e blerjes së energjisë;
- 1.4. raportin mbi statusin e pajisjeve kryesore;
- 1.5. raportin mbi indeksat e standardeve të kualitetit të furnizimit dhe shërbimit; dhe
- 1.6. çdo kontratë të lidhur mbi sigurimin, sipas udhëzimeve të përcaktuara në licencë.

Neni 26

Mbledhja dhe dorëzimi i të dhënave

1. Kur ZRRE-ja kërkon informacione, të dhëna ose dokumente, do t'i dërgojë të licencuarit njoftim me shkrim ku specifikohet koha në të cilën duhet të dorëzohen informacionet, të dhënat ose dokumentet.
2. Sipas kërkesës së ZRRE-së, i licencuari duhet të dorëzojë dëshmitë si në vijim:
 - 2.1. të dhënat mbi çmimet e energjisë elektrike apo ngrohjes, së bashku me të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet e bëra në lidhje me vendosjen e çmimeve;
 - 2.2. të dhënat mbi kapacitetin e instaluar dhe operativ për prodhim të propozuar për blerje ose të blera nga ndërmarrja për energji për një periudhë të caktuar;
 - 2.3. të dhëna mbi sasinë e prodhuar dhe/ose të shitur të energjisë elektrike apo ngrohjes, si dhe shumën e paguar sipas kontratave të shitjes;
 - 2.4. të dhëna mbi punën e kryer sipas zbatimit të kontratave për shitje të energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - 2.5. të dhëna mbi përmbushjen e standardeve të kualitetit të furnizimit dhe shërbimit (kohëzgjatjen, shpeshtësinë, numrin e ndërprerjeve dhe minutat e humbura për konsumatorët etj.) që i janë ofruar konsumatorëve.
 - 2.6. treguesit mbi shërbimet e sistemit (lidhjen në rrjet të konsumatorëve të rinj me kohë, riparimin e prishjeve të sistemit, mbajtjen e minutazhit sipas marrëveshjes për leximin e njehsorit, informacione të përgjithshme të matjes etj.);
 - 2.7. kopjet e kontratave të sigurimit financiar; dhe
 - 2.8. informacione të tjera që mund të lidhen me aktivitetet e licencuara.



Neni 27

Informatat konfidenciale

1. ZRRE-ja ka të drejtë të kërkojë informacione, të dhëna dhe dokumente sipas paragrafit 2 të këtij neni, pavarësisht nëse këto dokumente përmbajnë informacione konfidenciale ose me ndjeshmëri komerciale.
2. Kur dorëzohen të dhënat dhe dokumentet e kërkuara, i licencuari mund të identifikojë një informacion të siguar, ose mund të shënojë disa dokumente të dorëzuara, si konfidenciale dhe me ndjeshmëri komerciale, si dhe të kërkojë nga ZRRE-ja që të mos i bëjë publike këto informacione.
3. Sipas Rregullës për Informatat konfidenciale, ZRRE do të vendosë nëse dokumenti do të konsiderohet ose jo konfidencial.

Neni 28

Kriteret për ruajtjen dhe mbledhjen e informacioneve nga i licencuari

1. ZRRE-ja mund t'i kërkojë të licencuarit që të mbledhë dhe të mbajë informacione, të dhëna dhe dokumente që kanë të bëjnë me konsumatorët, pajisjet matëse, të dhëna në lidhje me matjet e cilësisë së furnizimit, dhe numrin e ankesave, duke përfshirë të dhënat si në vijim:
 - 1.1. emrin dhe adresën e konsumatorëve;
 - 1.2. vendndodhjen e pajisjeve matëse;
 - 1.3. shumën e kompensimit që i është paguar konsumatorit në rast të furnizimit të dobët me energji;
 - 1.4. numrin e kontratave të nënshkruara për kategori të ndryshme konsumatorësh fundorë;
 - 1.5. numrin dhe llojin e ankesave të regjistruara; si dhe
 - 1.6. informacione të tjera shtesë, që ZRRE i sheh si të nevojshme.

Neni 29

Monitorimi i aktiviteteve të licencuara

1. ZRRE-ja monitoron përmbushjen e aktiviteteve të licencuara, bazuar në të dhënat që i licencuari ka dorëzuar, në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.
2. I licencuari do të bashkëpunojë me ZRRE-në në sigurimin e të gjitha të dhënave të kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.
3. ZRRE-ja mund të kryejë inspektime fizike të stabilimenteve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetet e licencuara, në zyrat e të licencuarit (vizita periodike me ose pa njoftim paraprak) ose, sipas Nenit 32, paragrafi 3, të Ligjit për Energji, t'i kërkojë Inspektoratit për Energji të Ministrisë përgjegjëse që të kryejë inspektime në objektet e ndërmarrjeve të licencuara dhe t'i sigurojë ZRRE-së raport me shkrim mbi inspektimin.



Neni 30

Standardet e përmbushjes së aktiviteteve

1. I licencuari do të kryejë aktivitetin për energji në përputhje me standardet e përmbushjes në sektorin e energjisë, siç është përcaktuar në kodet teknike dhe komerciale, Rregullat e Tregut dhe rregullat e tjera të aprovuara nga ZRRE-ja.
2. Kontratat midis të licencuarit dhe konsumatorëve do të përpilohen në përputhje me dispozitat e Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Neni 31

Sigurimi

Me termat dhe kushtet e licencës do të përcaktohen detyrimet e sigurimit për çdo të licencuar.

KREU VII

VAZHDIMI, MODIFIKIMI, PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA E LICENCËS

Neni 32

Vazhdimi i licencës

1. ZRRE mund të vazhdojë kohëzgjatjen e çdo licence për një periudhë tjetër, në pajtim me Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me kusht që i licencuari të plotësojë të gjitha detyrimet dhe kërkesat në licencë, dhe të ketë dorëzuar një aplikacion me shkrim për vazhdim.
2. Aplikimi për vazhdim të licencës për aktivitetet e përcaktuara me licencë do të bëhet jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës, siç përcaktohet në Nenin 30, paragrafi 3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
3. Çdo kërkesë për vazhdim të licencës do të trajtohet nga ZRRE-ja në përputhje me procedurën për aplikim për licencë, të përcaktuar në këtë rregull.
4. Vazhdimi do të fillojë prej datës së skadimit të periudhës së vlefshmërisë së licencës.
5. Aplikacioni për vazhdim të licencës hartohet dhe publikohet nga ZRRE-ja.

Neni 33

Modifikimi/ndryshimi i licencës

1. Licencat mund të modifikohen me iniciativë të ZRRE-së vetëm në rrethanat vijuese:
 - 1.1. nëse ZRRE-ja e konsideron të nevojshme për të rritur konkurrencën,
 - 1.2. nëse paraqiten rrethana për të bërë ndryshime në obligimet e shërbimit publik,
 - 1.3. në raste të paraqitjes së rrethanave që rrezikojnë sigurinë e furnizimit me energji,



- 1.4. në raste të paraqitjes së rrethanave që rrezikojnë sigurinë shtetërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve ose mbrojtjen e mjedisit;
 - 1.5. në mënyrë që në licencë të përfshihen kritere të reja të përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga ligjet në fuqi në Kosovë, si dhe
 - 1.6. nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin energjetik në Kosovë.
2. Për çdo modifikim të licencës, ZRRE-ja do ta njoftojë të licencuarin me shkrim. Ky njoftim do të specifikojë bazat për modifikimin e propozuar dhe efektet që priten prej tij.
 3. Brenda katërmëdhjetë (14) ditësh prej datës së pranimit të njoftimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, i licencuari mund të dorëzojë një deklaratë me shkrim ku paraqet pikëpamjet e tij në lidhje me njoftimin e ZRRE-së për modifikimin e licencës, dhe të bashkëngjisë çdo dokument mbështetës.
 4. Modifikimi i licencës i nënshtrohet vendimit të ZRRE-së.

Neni 34

Modifikimi i licencës me kërkesë të të licencuarit

1. I licencuari mund të kërkojë modifikimin e licencës së tij në çdo kohë.
2. I licencuari do të dorëzojë të gjithë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për modifikim të licencës.
3. Modifikimi i licencës, me kërkesën e të licencuarit, i nënshtrohet vendimit të ZRRE-së.
4. Aplikacioni për modifikim të licencës hartohet dhe publikohet nga ZRRE-ja.

Neni 35

Pezullimi i licencës

Zyra e Rregullatorit për Energji mund të pezullojë përkohësisht licencën në rastet kur pezullimi arsyetohet. Në këtë rast, të licencuarit i jepet koha e arsyeshme për të korrigjuar veprimin e tij apo mosveprimin, si dhe kur i licencuari dëshmon aftësi dhe vullnet për të bërë një korrigjim të tillë.

Neni 36

Pezullimi, ndërprerja ose mbyllja e një stabilimenti të licencuar të prodhimit

1. Para ndërprerjes së licencës sipas Nenit 36 të kësaj rregulle, ZRRE-ja me iniciativën e vet ose me kërkesë të të licencuarit, dhe në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mjedis dhe me autoritetet e tjera relevante, do të aprovojë:
 - 1.1. pezullimin e licencës për prodhim të energjisë elektrike dhe ngrohjes për një periudhë të shkurtër kohore;



- 1.2. mbyllet e stabilimentit për energji, që i nënshtrohet kriterëve të kërkimit të një garancie financiare të depozituar në bankë dhe të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet;
 - 1.3. ndërprerjen dhe dekomisionimin e stabilimentit për prodhimin e energjisë dhe mbyllet e plotë të stabilimentit të energjisë; dhe
 - 1.4. nëse një stabiliment ekzistues për prodhim të energjisë punon me kapacitet më të ulët se 60% të kapacitet të aprovuar për një periudhë prej pesë (5) vitesh pa ndërprerje, atëherë mund të ekzekutohet pezullimi, ndërprerja apo mbyllja e licencës .
2. Duke u bazuar në Nenin 32 të kësaj rregulle, licenca mund të vazhdohet nëse ky vazhdim nevojitet për të lehtësuar mbyllet e aktivitetit të licencuar.

Neni 37

Ndërprerja apo tërheqja e licencës

1. Në pajtim me Nenin 35 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, çdo licencë e lëshuar mund të ndërpritet apo të tërhiqet nga ZRRE-ja në rastet si në vijim:
 - 1.1. me skadimin e afatit të vlefshmërisë, përfshirë zgjatjet e mundshme të afatit të saj;
 - 1.2. me kërkesë të të licencuarit, me kusht që detyrimet e të licencuarit të merren përsipër nga i licencuari tjetër, apo që konsumatorët të mos humbin nga kjo ndërprerje e licencës;
 - 1.3 me revokimin e saj nga ZRRE,
 - 1.4 me shpërbërjen e personit juridik që është bartës i licencës;
 - 1.5. me falimentimin e ndërmarrjes për energji;
 - 1.6. nëse aktiviteti i licencuar për energji nuk është kryer për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç nëse kjo është bërë me aprovimin e ZRRE-së;
 - 1.7. nëse janë plotësuar dispozitat e Nenit 36 të kësaj rregulle;
 - 1.8 nëse i licencuari dështon t'i përmbushë apo shkel kushtet apo detyrimet materiale të përcaktuara me licencë dhe nuk korrigjon dështimet e tilla brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.9 nëse aktivitetet e të licencuarit ndërpritën si rezultat i deklaramit të paaftësisë për të paguar apo likuidimit, megjithatë, ky nënparagraf nuk zbatohet për një proces të riorganizimit i cili mbikëqyret nga gjykata nëse i licencuari vazhdon veprimtarinë e tij gjatë këtij procesi; si dhe
 - 1.10 nëse i licencuari ka dorëzuar informacione jo të sakta që janë marrë si bazë për dhënien e licencës, si dhe që informatat e tilla kanë rëndësi të madhe për kryerjen e mirëfilltë të aktiviteteve të licencuara:



2. Një licencë mund të ndërpritet vetëm nëse Zyra e Rregullatorit për Energji konstaton se detyrimet e të licencuarit, përfshirë obligimet e shërbimit publik, mund të kryhen në mënyrë të kënaqshme nga një i licencuar tjetër ose kur konsumatorët nuk pësojnë nga ndërprerja e licencës.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta transferojë/bartë licencën që është ndërprerë te një i licencuar tjetër, me kusht që i licencuari i ri aplikon për licencë dhe atij i miratohet ajo.
4. Çdo kërkesë për ndërprerje ose tërheqje të licencës do të trajtohet nga ZRRE-ja në përputhje me procedurën për aplikim për licencë, të përcaktuar në këtë rregull.

KREU VIII

TRANSFERIMI I LICENCËS DHE TJETËRSIMI I ASETVE TË TË LICENCUARIT

Neni 38

Transferimi i licencës

1. Nëse i licencuari kërkon të transferojë licencën në një entitet tjetër, ai është i detyruar të marrë aprovimin paraprak të ZRRE-së për këtë transferim. Derisa të merret ky aprovim, i licencuari aktual është i detyruar të vazhdojë kryerjen e detyrimeve sipas licencës, derisa ZRRE-ja ta aprovojë transferimin.
2. Transferimi i licencës mund të aprovohet nga ZRRE-ja vetëm në rast se arsyet për këtë transferim janë të justifikuara nga aplikuesi, si dhe:
 - 2.1. nëse transferuesi i propozuar do të pranojë t'i kryejë detyrimet e mbetura të të licencuarit aktual, qoftë sipas licencës së të licencuarit aktual, kësaj rregulle, apo edhe sipas legjislacionit në fuqi; dhe
 - 2.2. nëse transferuesi i propozuar do të plotësojë të gjitha kushtet e parapara në këtë rregull dhe sipas legjislacionit në fuqi.
3. I licencuari i propozuar, përpara fillimit të aktivitetit, duhet të marrë aprovimin për transferim dhe licencën e transferuar nga ZRRE-ja.
4. Procedura e transferimit kryhet nga ZRRE-ja ashtu siç përdoret për dhënien e licencës. ZRRE-ja do të përcaktojë nëse i licencuari i propozuar është i aftë për të përmbushur kushtet e licencës. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës dhe përmbajtja e licencës do të mbeten të njëjta.
5. Aplikacioni për transferim të licencës do të hartohet dhe publikohet nga ZRRE.

Neni 39

Tjetërsimi i asetve të licencuara

1. Tjetërsimi i pajisjeve kapitale dhe të drejtave në pronën e paluajtshme që përdoren për kryerjen e aktiviteteve të licencuara do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.
2. Termat dhe kushtet e licencës duhet të përmbajnë dispozita në lidhje me aprovimet që kërkohen për tjetërsimin e pajisjeve kapitale dhe të drejtave në pronën e paluajtshme.



3. Ndërmarrjet e energjisë të licencuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të aplikojnë në Zyrën e Rregullatorit për Energji për një tjetërsim të tillë.

Neni 40

Mbrojtja e sistemit energjetik

Të gjithë vendimet në lidhje me lëshimin, modifikimin, tërheqjen ose përfundimin e një licence, do të merren vetëm nëse masat e duhura mbrojtëse për sistemin energjetik mund të sigurohen për të mbështetur këto vendime.

KREU IX DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 41

Gjobat

Nëse ndërmarrja e licencuar bën shkelje të dispozitave ligjore të kësaj rregulle dhe licencave të lëshuara nga ZRRE, ndaj saj do të shqiptohen masa administrative dhe gjoba në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 42

Apelimi i vendimit të ZRRE-së

Vendimi i ZRRE-së lidhur me lëshimin apo refuzimin për dhënien e Licencës, mund të kontestohet në gjykatën kompetente, sipas ligjeve në fuqi.

KREU X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Dispozitat kalimtare

Të gjitha licencat e lëshuara nga ZRRE-ja dhe që janë në fuqi në kohën e miratimit të kësaj rregulle, do të modifikohen në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, ligjet dhe rregullat e tjera në fuqi.

Neni 44

Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 45

Ndryshimi

1. ZRRE ka të drejtën që të ndryshojë ose modifikojë këtë rregull.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.



Neni 46
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 47
Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullin për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, të nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 24.02.2006.

Neni 48
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar